

V E N D I M
Nr.608, datë 30.10.1995

PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË SHQËRIVE SHQËTËRE PERSONAVE PJESËMARRËS NË ANKANDET PËR PRIVATIZIMIN E SHQËRIVE TREGTARE SHQËTËRE

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Numri dhe vlera e aksioneve të shoqërive shqëtare që privatizohen u transferohen personave fizikë dhe fondeve të investimeve, pjesëmarrës në ankand, pas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar të secilit ankand nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Vlera e aksioneve që transferohen i përgjigjet shumës të kapitalit themeltar që mbetet, pasi të jetë hequr kur është rasti

- pjesa e kapitalit themeltar që i përgjigjet vlerës nominale të aksioneve që shteti do të mbajë në shoqëri pas privatizimit (rasti i privatizimit të pjesshëm);

- pjesa e kapitalit themeltar që i përgjigjet vlerës nominale të aksioneve, të cilat i janë njohur ish-pronarit të truallit.

2. Numri dhe vlera nominale e aksioneve që i jepen çdo personi fizik apo fondi të investimeve, pjesëmarrës në ankand, do të përcaktohet në bazë të përqindjes së letrave me vlerë të privatizimit (bono ose lekë privatizimi) të depozituara nga çdo person ndaj vlerës gjithsej të këtyre letrave të depozituara për shoqërinë përkatëse të privatizuar.

Për të zvogëluar në maksimumin e mundshëm efektet e rumbullakimeve të përqindjeve ose të vlerave mundet që vlera nominale e një aksioni të caktohet më e vogël se ajo që është caktuar për shoqërinë shqëtare.

Në çdo rast duhet siguruar ruajtja e barazisë ndërmjet aksionarëve në përpjesëtim me kuotat-pjesë në kapitalin e shoqërisë së privatizuar.

Mbetjet e mundshme nga rumbullakimet të sistemohen në llogaritë e shoqërisë, në zmadhim ose në zvogëlim të rezervave nga rivlerësimi.

3. Pas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar të ankandit, një komision i caktuar nga kryetari i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe nga ministri i Financave nënshkruan dokumentet e rezultatit të ankandit, në të cilat duhet të përmenden këto të dhëna:

- numri dhe data e dokumentit;

- anëtarët e komisionit;

- emri i plotë dhe adresa e shoqërisë;

- vlera nominale e aksionit;

- lista e aksionarëve dhe numri i aksioneve, si dhe vlera e tyre për secilin aksionar.

Lista do të hartohet në tri kopje, nga të cilat një i dërgohet shoqërisë së privatizuar, një i dërgohet drejtorisë së shoqërive publike në Ministrinë e Financave dhe një ruhet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Lista e aksionarëve nuk publikohet.

Çdo aksionar ka të drejtë të njihet me këtë listë pranë shoqërisë përkatëse dhe, në rast paqartësie, mund të kërkojë sqarime pranë Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

4. Gjatë periudhës pas ankandit deri në mbledhjen e parë të asamblesë është e ndaluar çdo emetim dytësor i aksioneve nga ana e shoqërisë.

Gjatë kësaj periudhe nuk lejohet asnjë strukturim i kapitalit ekzistues.

5. Deri në zgjedhjen e organeve të reja të shoqërisë së privatizuar dhe kryerjes të ndryshimeve përkatëse të statutit, këshilli mbikëqyrës dhe drejtori i përgjithshëm i shoqërisë shqëtare do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre dhe do të mbajnë përgjegjësi të plotë për administrimin e pasurisë e të veprimëtarisë së shoqërisë.

Megjithatë aksionarët ose ortakët e shoqërisë së privatizuar kanë të drejtë të caktojnë me mandat të rregullt një komitet përfaqësues të përbërë nga një numër anëtarësh të barabartë me atë të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë shqëtare. Në këtë rast ky këshill zgjerohet, duke përfshirë edhe anëtarët e komitetit përfaqësues.

Këshilli mbikëqyrës merr përsipër hartimin e projektstatutit dhe kryerjen e të gjitha formaliteteve juridike të nevojshme për konfirmimin e shoqërisë me kërkesat e ligjit për shoqëritë tregtare.

6. Deri në zgjedhjen e organeve të reja të shoqërisë së privatizuar dhe hyrjen në funksion të këtyre organeve, as shoqëria dhe as ndonjë organ tjetër nuk kanë të drejtë të kryejnë ose të autorizojnë kryerjen e veprimeve që vijnë:

a) Shitjen e aktiveve të qëndrueshme të shoqërisë.

b) Blerjen e aktiveve të qëndrueshme ose kryerjen e investimeve të tjera, përveç atyre që kanë qenë të kontraktuara më parë.

c) Marrjen ose dhënien me qira të objekteve të ndryshme.

ç) Marrjen e huave, përveç atyre që kanë qenë kontraktuar më parë për nevoja rrjedhëse të veprimtarisë së shoqërisë.

d) Çdo veprim tjetër që do të sillte pakësimin e aktivitetit neto të shoqërisë.

Gjatë kësaj periudhe shoqëria nuk ka të drejtë gjithashtu të kryejë riorganizime që sjellin shkurtime në numrin e punonjësve.

7. Shoqëria shtetërore do të përgatitë gjendjen financiare për periudhën nga çelja e ushtrimit deri në datën e fundit të muajit kur është shpallur rezultati përfundimëtar i ankandit.

Gjendjet financiare do të përgatiten në bazë të kërkesave të ligjit “Për kontabilitetin” dhe të Planit Kontabël të Përgjithshëm. Ato do të verifikohen dhe do të vërtetohen nga një ose disa ekspertë kontabël të pavarur dhe duhet t’i paraqiten mbledhjes së parë të asamblesë së përgjithshme.

Në rastet kur data e fundit të muajit, kur është shpallur rezultati përfundimëtar i ankandit, përkon me datën e mbylljes së ushtrimit financiar ose nuk është më shumë se 60 ditë pas kësaj date, atëherë mund të mos hartohen gjendje financiare të tjera dhe asamblesë së përgjithshme t’i paraqiten llogaritë vjetore të ushtrimit që është mbyllur.

8. Shoqëria shtetërore e privatizuar do të trashëgojë të gjitha detyrimet kreditore të kërkueshme dhe të gjitha kërkesat debitore të arkëtueshme që figurojnë në llogaritë e shoqërisë në datën, për të cilën përgatiten gjendjet financiare. Ajo do të përgjigjet për shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit, sigurimeve shoqërore, bankave dhe kreditorëve të tjerë.

Detyrimet kreditore të pakërkueshme dhe kërkesat debitore të paarkëtueshme midis shoqërive shtetërore të mbyllen me provizionet e krijuara me rastin e transformimit të shoqërisë.

9. Ministritë e institucionet e tjera qendrore dhe organet e pushtetit lokal që sipas ligjit nr,7926, datë 29.4.1995, kanë emëruar anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive shtetërore, ngarkohen të ndjekin drejtpërdrejt procesin e transferimit të aksioneve të kapitalit të shoqërive shtetërore tek aksionarët ose ortakët e tjerë që hyjnë në këto shoqëri pas privatizimit si dhe t’i ndihmojnë këto shoqëri për hartimin e projektstatuteve, mbledhjet e para të aksionarëve dhe çështje të tjera gjatë periudhës deri në zgjedhjen e organeve të reja të shoqërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi